



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 104/02-6030/26
Kaçanik, 30.03.2026

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 30 mars 2026, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01 Nr. 104/02-6030/26 - më tekstin e mëtejme: Plani Vjetor i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2026, i hartuar nga KKSBB.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësynimet në lidhje me objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSBB, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2026.
3. Plani i Punës së KKSBB, është përmbledhur në gjithsej 5 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2021- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: Zyra e Kryetarit të Komunës (përmes saj njoftohen anëtarët e KKSBB), Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Seladin Troni



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality Kacanik

01 Br. 104/02-6030/26
Kaçanik, 30.03.2026

U skladu sa članom 12.1 i 12.2(d) u vezi sa članovima 40.1 i 40.2 Zakona br. 03/L-040 - o lokalnoj samoupravi (Službeni glasnik Republike Kosovo br. 28/04. jun 2008.), članom 6 Administrativnog uputstva br. 27/2012 MUP 03/2012 MLU, o opštinskim savetima za bezbednost zajednice, Skupština opštine Kačanik, na sednici održanoj 30. marta 2026. godine, usvojila je ovaj

ODLUKA
O ODOBRAVANJU GODIŠNJEG PLANA RADA OPŠTINSKOG VEĆA ZA
BEZBEDNOST ZAJEDNICE ZA 2026. GODINU

1. Ovom Odlukom se usvaja Plan 01 br. 104/02-6030/26 - sa sledećim tekstom: Godišnji plan rada Opštinskog saveta za bezbednost zajednice (OSPBZ) za 2026. godinu, koji je izradio OSPBZ.
2. Plan rada kao u tački 1. ove Odluke sadrži: ciljeve koji se odnose na zadatke iz oblasti aktivnosti koje su u nadležnosti OSPBZ, nivo njihove realizacije i broj sastanaka za 2026. godinu.
3. Plan rada OSPBZ je sumiran na ukupno 5 stranica i isti je sastavni deo ove Odluke.
4. Ova Odluka stupa na snagu u skladu sa članom 17. Uredbe (MLGA) br. 01/2021 - o postupku izrade i objavljivanja opštinskih akata.

Ovom Odlukom se obaveštavaju: Kancelarija gradonačelnika (preko koje se obaveštavaju članovi Opštinskog veća), Arhiva.

Predsedavajuć Skupštine
Selajdin Troni





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



| 1 | Data | Numri | Vendi | Shtojcë |
|---|----------|--------|---------|---------|
| | 11.03.26 | 104/02 | Kaçanik | 6030 |



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

PLANI VJETOR I PUNËS
I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)
PËR VITIN 2026



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipality of Kacanik

PLANI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) përben një mekanizëm të rëndësishëm të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel lokal për adresimin e çështjeve që lidhen me sigurinë publike dhe mirëqenien e qytetarëve. Ky plan vjetor i punës për vitin 2026 është hartuar për të përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet kryesore që do të ndërmerren nga institucionet lokale në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe partnerët e komunitetit.

Qëllimi i këtij plani është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, parandalimi i dukurive negative dhe rritja e sigurisë për të gjithë qytetarët e komunës. Përmes këtij dokumenti përcaktohen objektivat strategjike, aktivitetet konkrete dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të tyre gjatë vitit 2026.

Korniza Ligjore dhe Institucionale

KKSBB funksionon në përputhje me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës dhe me udhëzimet administrative që rregullojnë funksionimin e këtyre mekanizmave në nivel lokal. Ky këshill shërben si platformë për dialog dhe koordinim ndërmjet institucioneve dhe komunitetit për çështje që lidhen me sigurinë publike.

Komuna i siguron kushte të punës për mbajtje të takimeve të KKSBB-së, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë takimeve. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha takimet dhe rekomandimet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, i'u krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në proceset e zbatimeve të rekomandimeve.

Plani vjetor i punës së KKSBS-së është dokument i mbështetur në Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të miratuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat komunal për siguri në bashkësi dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore.

Plani vjetor i punës është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të KKSBS-së të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Udhëzimi Administrativ Nr. 27/2012 të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të miratuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat komunal për siguri në bashkësi dhe aktet tjera primare dhe sekondare.

Objektivat Strategjike për Vitin 2026

1. Rritja e sigurisë në institucionet arsimore dhe parandalimi i dukurive negative.
2. Përmirësimi i sigurisë në trafikun rrugor dhe hapësirat publike.
3. Rritja e bashkëpunimit ndër-institucional në adresimin e çështjeve të sigurisë.
4. Fuqizimi i mbrojtjes për grupet e cënueshme.
5. Përmirësimi i mekanizmeve të monitorimit dhe raportimit.

Këto objektivat strategjike përfaqësojnë drejtimet kryesore të veprimit të KKSBS-së gjatë vitit 2026 dhe synojnë të krijojnë një qasje të koordinuar për adresimin e sfidave të sigurisë në komunë.

PLANI VJETOR I PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSIPËR PERIUDHËN PRILL-DHJETOR 2026

| Nr. | Muaji | Tema Kryesore | Çështjet që Diskutohen | Përgjegjësit | Akterët që Marrin Pjesë | Rezultatet e Pritshme |
|-----|---------|--|--|---|---|--|
| 1 | Prill | Siguria në shkolla dhe siguria në internet | Masat kundër dhunës dhe bullizmit; Mekanizma për raportim anonim; Trajnime për mësimmshënës; Vetëdijësim për rreziqet online | KKSB, Drejtoria e Arsimit, Policia | Psikologët e shkollave, Këshillat e Prindërve, OJQ-të | Plan konkret për rritjen e sigurisë në shkolla |
| 2 | Qershor | Siguria në trafikun rrugor dhe hapësirat publike | Identifikimi i pikave të rreziqshme; Vendosja e sinjalizimit rrugor; Ndricimi publik; Fushata vetëdijësuese | KKSB, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Policia | Komuniteti lokal, shkollat, OJQ-të | Lista e prioriteteve për ndërhyrje |
| 3 | Gusht | Siguria për grupet e cënueshme dhe përshirja e komunitetit | Siguria për PAK, të moshuarit dhe gratë; Identifikimi i barrierave; Fugzimi i grupeve lokale të sigurisë | KKSB, Drejtoria e Mirëqenies Sociale | OJQ-të, komuniteti | Rekomandime për siguri gjithëpërfshirëse |
| 4 | Tetor | Planifikimi i emergjencave dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore | Përditësimi i planit emergjent; Identifikimi i objekteve kritike; Simulime; Informimi i qytetarëve | KKSB, Drejtoria e shërbimeve publike | Policia, Zjarrfikësit, QKMF, Kryqi i Kuq | Rritja e gatishmërisë institucionale |
| 5 | Dhjetor | Vlerësimi i gjendjes së sigurisë dhe rekomandimet për vitin 2027 | Analiza e zbatimit të vendimeve; Vlerësimi i gjendjes; Hartimi i rekomandimeve | KKSB, Kryetari i Komunës | Të gjithë akterët relevantë | Raport përfundimtar me rekomandime |

Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Kosovës, Komunës, institucioneve arsimore dhe organizatave të shoqërisë civile është thelbësor për realizimin e objektivave të këtij plani. Përmes këtij bashkëpunimi synohet rritja e efektivitetit të aktiviteteve parandaluese dhe përmirësimi i komunikimit me komunitetin.

Monitorimi dhe Vlerësimi

KKSB do të monitorojë zbatimin e këtij plani përmes takimeve të rregullta çdo dy muaj. Në këto takime do të analizohen raportet e institucioneve përgjegjëse dhe do të diskutohen progresi dhe sfida të zbatimit e aktiviteteve të planifikuara.

Përfundim

Ky plan përfaqëson një përkushtim të përbashkët të institucioneve lokale për të krijuar një mjedis më të sigurt për qytetarët. Miratimi i tij nga Kuvendi Komunal do të mundësojë zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e sigurisë publike.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2026, ku Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, planifikon t'i mbajë 6, (gjashtë) takime të rregullta, 3 (tri) prej të cilave në (6) gjashtëmuajorin e parë dhe 3 (tri) prej të cilave në 6, (gjashtëmuajorin) e dytë të vitit 2026, në të cilat do të trajtohen të gjitha gëshjtet e sigurisë në bashkësi që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Kaçanikut.

Plani vjetor i punës së KKSB-së, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të KKSB-së, duke iu ofruar anëtarëve të KKSB-së këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2026 e që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi dhe për interesat e qytetarëve. Përveç këtyre temave të cekura më poshtë, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, do të shqyrtojë dhe analizojë edhe tema apo gëshje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunitetin në lidhje me sigurinë në bashkësi.

Përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026

Sabedin Vishi – Kryetar i Komunës
Xhelal Dema – Nënkryetar i Komunës
Gazmend Bunjaku – Drejtoria e Arsimit
Arian Teneqja – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia
Betim Shala – Komiteti për Komunitete
Vedat Dema – Zyra për Barazi Gjimore
Emrush Lalinovci – Komandant i Stacionit Policor Kaçanik
Vedat Shatri – FSK
Fidaim Fazliu – KBI
Fatmir Qaka – EVSB
Shqiponje Vogliqi Rexhepi – KLSP
Deana Muhaxheri – Përfaqësuese e Komuniteteve
Elmihane Malsiu – HANDIKOS Kaçanik
Naim Hysa – Kryqi i Kuq Komunal
Emrin Dema – Këshilli i Prindërve
Ylber Tusha – Përfaqësues i bizneseve

Hartuar nga:

Gazmend Bunjaku-DKA

Deana Muhaxheri-Përfajqsuese e Komuniteteve,

Elmihane Malsiu-HANDIKOS Kaçanik

Komuna Kaçanik
Datë: 11.03.2026
Kryetari i Komunës

